


**BULETINI MAJ**  
**2011**



**NE KETE BULETIN DO TE GJENI:**

- ❖ Takim me Presidentin e Republikës.
- ❖ Parlamenti Rinor Shqiptar, vizitë në Kosovë .
- ❖ Të rinj, ju mund të punësoni një kryebashkiak!
- ❖ Konkursi në facebook “Ekspozitë Fotografike”
- ❖ Parapergatitje per zhvillimin e zgjedhjeve.

Vlen për t'u theksuar fakti se këto aktivitete kanë patur një mbulim të konsiderueshëm nga media, gjithashtu ato janë pasqyruar edhe në web site-n tone, por edhe në faqet tona në Facebook!

Parlamenti Rinor është themeluar nga  në vitin 2000.

Misioni i Parlamentit Rinor është [të rrisë pjesmarrjen e të rinjve në vendimmarrje.](#)

**Parlamenti Rinor**

**Informacione kontakti**

**Email:** info@parlamentirinor.al

**Facebook:** Parlamenti Rinor

**Website:** <http://www.parlamentirinor.al>

## TAKIM ME PRESIDENTIN E REPUBLIKES

Tirane me 03/05/11



Gjatë takimit, vlerësuam kontributin e Presidentit të Republikës në përmirësimin e dialogut politik në Shqipëri, por edhe rolin që ai ka luajtur në mbrotje të shtetit ligjor dhe Kushtetutës. Gjithashtu i shprehëm Presidentit, shqetësimin tonë për [retorikën e ashpër që po përdoret prej liderëve politik](#) si dhe akteve të dhunës që po shoqërojnë këtë fushatë.



Ne i [kërkuam Presidentit të Republikës t'iu bëjë apel partive politike](#) që të ulin tensionet mes palëve; të mos përdorin fëmijët nën moshën tëmbëdhjetëvjeçare në fushatat elektorale; të mos i shkëpusin nxënësit nga aktiviteti mësimor; të heqin dorë nga demagogjitë e të angazhohen seriozisht për zgjidhjen e problemeve të të rinjve; e mbi të gjitha, të përfshijnë të rinjtë në procesin e vendimmarrjes lokale, pasi të rinjtë nuk janë vetëm e ardhmja, por edhe e sotmja

[http://www.parlamentiriyor.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=167:parlamenti-rinor-tek-presidenti-i-republikes-kunder-dhunes-ne-fushaten-zgjedhore&catid=56:njoftime-a-deklarata&Itemid=71](http://www.parlamentiriyor.al/index.php?option=com_content&view=article&id=167:parlamenti-rinor-tek-presidenti-i-republikes-kunder-dhunes-ne-fushaten-zgjedhore&catid=56:njoftime-a-deklarata&Itemid=71)  
<http://president.al/shqip/info.asp?id=6642>

## PARLAMENTI RINOR VIZITE NE KOSOVE

Prishtine me date 05/05/11



Me ftesën e kryesisë së Kuvendit të të rinjve të Kosovës, më datë 05/05/11 përfaqësues të Parlamentit Rinor shkuan në Kosovë ku morëm pjesë në një [seancë solemne në Pallatin e qeverisë](#). Atje u pritëm në Kuvend, ku takuam mjaft figura të njohura të Politikës Kosovare, ku ndër më të rëndësishmet mund të përmendim takimin me Presidenten e sapo zgjedhur të Kosovës.



Po ate ditë qe percaktuar në axhenede [homazhet në vendin e prehjes së Presidentit historik së Kosovës Dr.Ibrahim Rugova](#), më pas vizituam familjen e tij, ku patëm një bisedë të ngrohtë e impresionuese, me gruan dhe fëmijët e tij.



Më datë 06.05.2011 në orën 09:00, nënshkruam [Memorandum-bashkëpunimit](#) mes dy Parlamenteve Rinore me qëllim realizimin e projekteve të përbashkëta për një mirëqenie më të mirë të rinisë shqiptare. Po ate ditë ishim të ftuar KK Pejë, ku u themelua Asambleja rinore e Pejës.

<http://www.facebook.com/media/set/?set=a.10150171538892307.303389.29771032306>  
<http://www.parlamentiriyor.al/>

## TE RINJ JU MUND TE PUNESONI NJE KRYEBASHKIAK!

Tirane me 07/05/11



Dhjetra të rinj të Parlamentit Rinor u drejtuan ditën e shtunë një thirrje të rinjve në mbarë vendin. Ata i kërkuan [të rinjve të marrin në dorë fatin e qytetit të tyre](#) dhe të vendosin jo vetëm për ta por edhe për familjet e tyre. Të rinjtë i drejtuan thirrje të ndryshme për të gjitha qytetet e vendit duke evidentuar disa nga çështjet vendore të cilat mund të zgjidhen me votën e të rinjve.



Një thirrje e veçantë ju drejtua edhe [votuesve për herë të parë](#) duke synuar t'i ndërgjegjësojë ata që të mos e humbasin mundësinë për t'u bërë pjesë e vendimmarrjes, e duke i kujtuar atyre se nesër ata mund të punësojnë një kryebashkiak.

[http://www.parlamentirinor.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=170:te-rinj-neser-ju-mund-te-punesoni-nje-kryebashkiak&catid=133:rinia-ne-zgjedhje](http://www.parlamentirinor.al/index.php?option=com_content&view=article&id=170:te-rinj-neser-ju-mund-te-punesoni-nje-kryebashkiak&catid=133:rinia-ne-zgjedhje)

<http://www.youtube.com/watch?v=Yug345zwEly>

<http://www.youtube.com/watch?v=JNXs3-4dC2Y&feature=related>

## Zgjedhjet neper shkolla.

Tirane me 15-30/05/11



Parlamenti Rinor ka filluar per zgjedhjet rinore neper shkolla ku cdo dite dhjetera te rinj plotesojne formularet e anetaresise. Kjo fushate ka per qellim kryesor te saj edukimin e te rinjve me pariemt demorkatike ten je procesi te rregullt zgjedhor,informimin mbi sistemet e ndryshme zgjedhore dhe ritjen e pjesmarrjeses se te rinjve ne vendimmarrje.